

20140411153

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR THEMELIMIN E  
KOMISIONIT SHTETËROR PËR VENDIMMARRJE NË PROCEDURË  
ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURË TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË SHKALLË  
TË DYTË**

Neni 1

Në Ligjin për themelimin e Komisionit Shtetëror për Vendimarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 51/11 dhe 148/13), në nenin 1 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Komisioni Shtetëror është kompetent për zgjidhjen e ankesave kundër aktvendimeve të miratuara në shkallë të parë nga Komisioni për Letra me Vlerë."

Paragrafët (3), (4) dhe (5) bëhen paragrafë (4), (5) dhe (6).

Neni 2

Në nenin 2 në paragrafin (2) fjala "shtetërorë" zëvendësohet me fjalën "administrativë".

Neni 3

Në nenin 3 në paragrafin (2) fjalët: "përmes konkursit publik" shlyhen.

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror publikohet shpallje publike në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat një nga gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Paragrafi (4) i cili bëhet paragraf (5) ndryshohet si vijon:

"(5) Si kryetar i Komisionit Shtetëror emërohet personi i cili i përmbush kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose ka kryer shkallen e arsimit VII/1 nga sfera e drejtësisë;
- 4) të ketë minimum pesë vjet përvojë pune në punë administrative;
- 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

-TOEFEL IBT-së paku 74 pikë,

-IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,

-ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),

-FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të dhënë,

-BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose

-APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe

6) të ketë dhënë testin psikologjik ose testin e integritetit."

Paragrafi (5) i cili bëhet paragraf (6) ndryshohet si vijon:

(6) Si anëtar i Komisionit Shtetëror emërohet personi i cili i përmbush kushtet në vijim:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) ka fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose të ketë kryer shkallën VII/1;

- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në punë administrative;
  - 5) posedon një nga certifikatat ose dëshmitë e pranuar ndërkombëtare vijuese për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
    - TOEFEL IBT-së paku 74 pikë,
    - IELTS (IELTS) – së paku 6 pikë,
    - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal ) - së paku niveli B2 (B2),
    - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të dhënë,
    - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë ose
    - APTIS (APTIS) – së paku niveli B2 (B2) dhe
  - 6) të ketë dhënë testin psikologjik ose testin e integritetit."
- Paragrafët (6) dhe (7) bëhen paragrafë (7) dhe (8).

#### Neni 4

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të emëruar deri në ditën e fillimit me zbatimin e nenit 3 të këtij ligji vazhdojnë ta ushtrjnë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin janë emëruar.

#### Neni 5

Dispozitat e nenit 1 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të dispozitave nga nenet 8, 9, 13 dhe 15 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letra me vlerë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 188/13).

Dispozitat e nenit 2 të këtij ligji do të fillojnë së zbatuari me ditën e fillimit të zbatimit të Ligjit për nëpunësit administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14) dhe Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

Dispozitat e nenit 3 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç dispozitave që kanë të bëjnë me kushtin për njohjen e gjuhës së huaj të cilat do të fillojnë së zbatuari pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".